

VENDIM
Nr. 115, datë 13.2.2013

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 167, DATË 10.3.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË
PËRDORIM TË BASHKISË KUKËS TË QARKUT TË KUKËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në listën përfundimtare, që i bashkëlidhet vendimit nr. 167, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave, për të dhënat për pronat me numrat rendorë 945-952 (nëntëqind e dyzet e pesë deri në nëntëqind e pesëdhjetë e dy), gjithsej 1 (një) fletë, sipas formularit dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Kukës të qarkut të Kukësit, shtohen pronat me numrat rendorë 966-988 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë deri në nëntëqind e tetëdhjetë e tretë), gjithsej 3 (tre) fletë, sipas lidhjes nr. 1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha